



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 30 dhjetor 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: nëntor 2024

- Norma mesatare e interesit të totalit të kredive, në nëntor 2024, shënoi rënie mujore dhe vjetore prej 0,02 p.p. dhe 0,12 p.p., respektivisht dhe shënon 5,36%. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave shënon 2,12% dhe është rritur në baza mujore dhe vjetore për 0,05 p.p. dhe respektivisht, 0,38 p.p.
- Në nëntor, norma mesatare e interesit të kredive të reja² shënon 4,82% dhe shënoi rritje mujore prej 0,01 p.p., me rënie vjetore prej 0,56 p.p. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja është ulur për 0,04 p.p. në bazë mujore dhe është 2,80%, me rritje vjetore prej 0,52 p.p.

Tabela 1. Normat e interesit të totalit të kredive dhe depozitave të reja

	11.2023	12.2023	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024	8.2024	9.2024	10.2024	11.2024
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.48	5.47	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46	5.44	5.41	5.38	5.36
Korporatat	5.36	5.33	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23	5.20	5.15	5.09	5.05
Amviseritë	5.59	5.59	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67	5.66	5.66	5.66	5.66
Kreditë e reja	5.38	5.21	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12	5.04	4.98	4.81	4.82
Korporatat	5.39	5.30	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96	4.90	4.78	4.65	4.68
Amviseritë	5.35	5.02	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34	5.28	5.27	5.17	5.03
Depozitat	1.74	1.79	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93	1.96	2.01	2.07	2.12
Korporatat	2.23	2.06	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28	2.20	2.34	2.42	2.68
Amviseritë	1.69	1.76	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89	1.93	1.97	2.02	2.05
Depozitat e reja	2.28	2.37	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76	2.43	2.60	2.84	2.80
Korporatat	1.71	2.19	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03	1.99	2.14	2.75	2.43
Amviseritë	2.46	2.42	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68	2.76	2.79	2.89	2.88

Burimi: BPRMV-ja.

¹ Me termin "normë interesi" nënkuptohet normë e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shihni Metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf



² Lidhur me normata e interesit të kredive të reja / depozitat e reja janë karakteristike zhvillime të ndryshueshme. Lëvizjet e tilla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord rishtazi e interesit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



1. Norma të interesit në sektorin korporativ³

- Në nëntor 2024, norma mesatare e interesit e totalit të kredive të sektorit korporativ është ulur për 0,04 p.p. dhe shënon 5,05%. Ndryshimi në rënie rezulton nga rënia e të gjitha komponentave: normat e interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,19 p.p.), normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,02 p.p.) dhe normat e interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,01 p.p.). Analizuar në bazë vjetore, kjo normë interesi është ulur për 0,31 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.

- Norma e interesit për kreditë e sapomiratuara për sektorin korporativ, këtë muaj, arrin 4,68% dhe shënoi rritje mujore prej 0,03 p.p. Analizuar sipas valutave, ndryshimi është tërësisht rezultat i rënies së normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,11 p.p.), ndërsa normat e interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore dhe kredive në valutë të huaj janë ulur (për 0,19 p.p. dhe 0,10 p.p., përkatësisht). Norma e interesit për kreditë e sapomiratuara për sektorin korporativ është ulur për 0,71 p.p. në bazë vjetore.



Burimi: BPRMV-ja.


³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo-financiare (publike dhe të tjera).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në nëntor, norma mesatare e interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ shënoi rritje mujore prej 0,26 p.p. dhe shënon 2,68%. Ndryshimi në rritje është rezultat i rritjes së normave të interesit të të gjitha komponentëve, dhe atë: normat e interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,28 p.p.) dhe normat e interesit të depozitave në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,25 dhe 0,22 p.p.). Në krahasim me nëntorin e vitit të kaluar, kjo normë e interesit është rritur për 0,45 p.p.
- Norma e interesit për depozitat e sapo pranuar⁴ të sektorit korporativ, këtë muaj, arrin 2,43% dhe në nivel mujor është ulur për 0.32 p.p. Njëkohësisht, rënia është rezultat i rënies së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,34 p.p.), në kushte të normave të pandryshuara të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore dhe rritjes së depozitave në valutë të huaj (për 0,17 p.p.). Në nivel vjetor, norma e interesit për depozitat e sapo pranuar të sektorit korporativ shënoi rritje për 0,72 p.p.

2. Norma të interesit për amvisëritë⁵



Burimi: BPRMV-ja.





- Në nëntor 2024, norma e interesit e totalit të kredive për amvisëritë është 5,66% dhe mbetet e pandryshuar në krahasim me muajin paraprak. Analizuar në bazë vjetore, kjo normë interesi është rritur për 0,07 p.p.
- Këtë muaj, norma mesatare e interesit për kreditë e sapomiratuara për amvisëritë është ulur për 0,14 p.p. në bazë mujore dhe shënon 5,03%. Rënia është rezultat i uljes së normave të interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,28 p.p. dhe për 0,10 p.p., respektivisht) ndërsa normat e interesit të kredive në valutë të huaj janë rritur (për 0,06 p.p.). Krahasuar në bazë vjetore, kjo normë e interesit shënon rënie për 0,32 p.p.

⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV-ja.

- Në nëntor, norma e interesit e totalit të depozitave për amvisëritë shënon rritje për 0,03 p.p. dhe arrin 2,05%. Rritja është rezultat i normave më të larta të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe të depozitave në valutë të huaj (për 0,04 p.p. dhe 0,02 p.p., respektivisht), ndërsa normat e interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore janë ulur (për 0,11 p.p.). Krahësuar me muajin e kaluar të vitit paraprak, norma e interesit e totalit të depozitave për amvisëritë është rritur për 0,36 p.p.
- Norma e interesit të depozitave të sapopranuara të amvisërive⁶, këtë muaj arrin 2,88% dhe realizoi rënie prej 0,01 p.p. Ndryshimi tërësisht është rezultat i rënies së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,11 p.p.), me norma të pandryshuara të normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore. Në nëntor, te bankat dhe kursimoret nuk janë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Norma e interesit të depozitave të sapopranuara për amvisëritë është rritur për 0,42 p.p. në bazë vjetore.

⁶ Në grafikon që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione mbështetëse

Seri kohore të të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendari i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 31 janar 2025 (mesatare referuese, përfshirë nëntorin e vitit 2024).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235, lok. 108/110.